



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna –Hani i Elezit
Municipality of Hani Elezit

Nr.01/ 56 /2011

Në bazë të nenit 17, pika 17.1, shkronja n të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 38të Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, Udhëzimit administrativ nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes meshumicë dhe pakicë dhe për ndërmjetësim në tregti, të nenit 6 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me 30.06.2011, miratoi

R R E G U L L O R E N
P Ë R
DHËNIEN E LEJES SË PUNËS ORGANIZATAVE TË BIZNESIT
NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet për dhënie e lejes së punës për organizatat e biznesit që janë të regjistruara në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare.

Neni 2

Sipas kësaj Rregulloreje, asnjë organizatë e biznesit nuk lejohet të ushtrojë veprimtari afariste në kundërshtim me ligjin, pa leje pune të lëshuar nga organi përkatës.

Neni 3

3.1. Me këtë Rregullore, përpos kushteve të përgjithshme të parapara me ligjet në fuqi dhe me akte nënligjore, caktohen edhe këto kushte të veçanta, të cilat duhet plotësuar për marrjen e lejes së punës:

- a) Certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga MTI – ja; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- b) Pëlqimi i dhënë nga Komisioni për pranimin e kushteve minimale - teknike dhe sanitare;
- c) Dëshmia për pronësinë e lokalit afarist, Vendimi për shndërrimin e lokalit për banim në lokal afarist ose kontrata mbi qiranë e lokalit afarist të vërtetuar nga gjykata;
- d) Fotokopja e lejes së ndërtimit;
- e) Dëshmia mbi pagesën për marrjen e Lejes së Punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste (tregtare) në vlerë prej **40€**;
- f) Dëshmia se i ka paguar të gjitha obligimet ndaj buxhetit komunal.
- g) Dëshminë mbi licencën apo certifikatën për ushtrimin e veprimtarisë për shërbimet profesionale

3.2. Për marrjen e lejes së punës për kafe – baret, disko klubet dhe klube të natës, kërkohet edhe pëlqimi i dhënë nga banorët në pjesën ku ushtrohet veprimtaria, si dhe duhet të merren parasysh parametrat e zhurmës apo rrezja e saj, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

3.3. Organizatat e biznesit duhet të paguajnë taksën vjetore, në pajtim me dispozitat e Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale.

Neni 4

4.1. Dhënia e lejes së punës, në zbatim të nenit 4.1 të kësaj Rregullore, nuk e liron pronarin, respektivisht shfrytëzuesin e objektit, që mos t'i kryejë obligimet lidhur me kushtet e ndërtimitarisë, kushtet urbanistike dhe teknike - sanitare të parapara me aktet tjera ligjore.

4.2. Organi kompetent për lëshimin e lejes së punës, në pajtim me këtë Rregullore dhe me ligj, ka për obligim të përcjellë përmbushjen e kushteve urbanistike - teknike dhe sanitare edhe pas dhënies së pëlqimit për përmbushjen e kushteve minimale teknike të lokaleve afariste dhe dhënies së lejes së punës.

Neni 5

5.1. Sipas kërkesës së palës për dhënien e lejes, organi kompetent është i obliguar, në afat prej **15** ditësh, të marrë Vendim për miratimin apo refuzimin e kërkesës.

5.2. Organi kompetent e jep lejen e punës, sipas nenit 5.1 të kësaj Rregulloreje, pas plotësimit të kushteve të parapara me nenin 38.1 të Ligjit për tregtinë e brendshme dhe me dispozitat e nenit 3, pika 3.1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

6.1. Leja e punës do të ndryshojë nëse organizata e biznesit ndryshon adresën, ndërrohet pronari i organizatës ose ndërrohet veprimtaria.

6.2. Afati për ndryshimin e lejes për rastet e përmendura në nenin 6.1 të kësaj Rregulloreje, është tri ditë nga dita e ndryshimeve që bëhen në certifikatë dhe në listën e veprimtarive.

Masat mbikëqyrëse

Neni 7

7.1. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje do ta bëjnë: Inspektorati i tregut dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

7.2. Nëse inspektori i autorizuar konstaton se aktiviteti afarist nuk është i regjistruar, apo nuk posedon leje pune, ai/ajo mund të ndalojë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë afariste, deri në eliminimin e këtyre parregullsive.

7.3. Ankesa kundër Vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

7.4. Ankesa kundër Vendimit të inspektorit të tregut, i drejtohet Inspektoratit të Tregtisë pranë MTI – së, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.

7.5. Vendimi i Inspektoratit të MTI - së jepet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur është pranuar ankesa dhe ndaj të njëjtit mund të paraqitet padi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjobat

Neni 8

Në rast se organizatat biznesore gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre nuk janë të pajisura me leje pune, atëherë do të zbatohen dispozitat e Ligjit të tregtisë së brendshme. Me gjobë mandatare do të gjobiten personat fizik dhe juridik në vlerë prej 100 euro.

Neni 9

9.1. Lidhur me shkeljet e supozuara dhe zbatimin e gjobave, inspektori i tregtisë duhet të procedojë – inicijë lëndën në Gjykatën për Kundërvajtje.

9.2. Procedurën për shkelje e udhëheq Gjykata Komunale për Kundërvajtje .

9.3. Procedurat, udhëheqja e të cilave nuk ka përfunduar, procedohen sipas dispozitave që kanë qenë deri në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, nëse ndryshe nuk është caktuar me ligj.

Dispozitat përfundimtare

Neni 10

Rregullorja për leje pune të subjekteve afariste do të zbatohet do të zbatohet në Komunën e Hanit të Elezit dhe në rast se ndonjëra nga dispozitat e saj do të jetë në kundërshtim me dispozitat e Ligjeve përkatëse do të zbatohet Ligji.

Neni 11

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunes së Hanit të Elezit

Data : 30.06.2011

Hani i Elezit



Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Mashi